



Edukim i hershëm në pikëpamje të pedagogjisë shëruese (HFE)

Në qoftë se një fëmijë nuk i bën përparimet, të cilat i presin prindërit dhe rrethi, menjëherë paraqitet një farë pasigurie. Kjo bëhet para së gjithash në ato raste, kur nuk janë të dukshme shkaqet e qarta.

Të lozurit e një fëmije nuk është konform moshës së saj. Përballë bashkëmoshatarëve, fëmija duket të jetë mbrapa për sa i përket aftësisë së të folurit. Gjatë marrëdhëneve me gjësende dhe me njerëz, fëmija manifeston sjellje të çuditshme. I gjithë zhvillimi i fëmijës bëhet me vonesë ose në mënyrë jo harmonike.

Edukimi i hershëm në pikëpamje të pedagogjisë shëruese, si ofertë vullnetare dhe falas, në këto momente mund të paraqitet si një mbështetje, si këshillim dhe shoqërim. Ajo bëhet në përditshmërinë e fëmijës, duke e mbërthyer edhe ambientin e fëmijës si dhe mundësitë familjare.

Për të gjitha ofertat e (HFE) duhet të bëhet dërgimi mjekësor.

Sqarim i kujdesshëm

Shpesh herë ndodh që prindërit ose pediatrët të konstatojnë një zvarritje në zhvillimin e fëmijës. Por ndodh që edhe edukatorët, këshilltarët e nënave / baballarëve ose bashkëpunëtorët e kopshteve të konstatojnë diçka tek fëmijët, duke parë të jetë e rekomandueshëm një sqarim i gjërave. Si plotësim i diagnozës mjekësore nga ana e mjekëve, ne ju ofrojmë një sqarim në pikëpamje të zhvillimit psikologjik.

Sqarimi në fjalë përmban:

- Bisedimet rreth situatës aktuale dhe rreth parahistorisë
- Vëzhgimin e sjelljeve gjatë të lozurit
- Testet e standartizuara
- Aplikimin e shkallëve të zhvillimit
- Pyetësorin për prindërit

Ky sqarim i kujdesshëm dhe gjithëpërfshirës, mbërthen gjendjen e zhvillimit të fëmijës në të gjitha shkallët e saj, duke dhënë kështu një pasqyrë të personalitetit të saj me resurset dhe me vështirësitë e saj.

Në këtë bazë, mund të merret vendimi «Edukimi i hershëm në pikëpamje të pedagogjisë shëruese – po ose jo» apo mund të bisedohen edhe oferta të tjera alternative.

Mbështetja dhe shoqërimi i prindërve

Për prindërit gjegjisht për personat referues të rrethit, ne ofrojmë mbështetje dhe shoqërim gjatë situatave të vështira të edukimit. Me këtë ne dëshirojmë të forcojmë besimin e prindërve gjegjisht të personave përkatës referues, për sa i përket mundësive të tyre si dhe zgjerimit të kompetencave të tyre në pikëpamje të edukimit të fëmijës.

Në kuadër të këshillimit, bëjnë pjesë edhe ndihmat si dhe rekomandimet rreth futjes së fëmijës suaj në kopsht.

Intervenimet terapeutike familjare apo trajtimi i problemeve bashkëshortore apo të partneritetit nuk përbëjnë pjesë të ofertës (HFE).

Nxitja e caktuar e fëmijës suaj

(HFE) është një ofertë pedagogjike-terapeutike për fëmijët që nga lindja e tyre e deri tek moshë kur futen në kopsht. Gjatë nxitjes gjegjisht përkrahjes pedagogjike shëruese, ne e mbështesim fëmijën tuaj në zhvillimin e saj në fushat e përcëpimit, të gjuhës, të lëvizjes, të të sjellurit në fushën sociale, të lozurit dhe të mësuarit.

Duke qenë se fëmija e vogël jeton në një botë të lojës, edhe nxitja gjegjisht përkrahja fillon pikërisht tek loja, duke zbatuar metoda, që bazohen tek njohuritë pedagogjike, psikologjike, mjekësore dhe sociologjike.

Edukimi i hershëm në pikëpamje të pedagogjisë shëruese vazhdimisht i përshtatet proceseve të mësimin dhe të përvojës. Pikërisht për këtë arsye, bashkëpunimi aktiv i të gjithë pjesëmarrësve në edukim, është i dëshiruar, madje është edhe i nevojshëm. Së bashku i përpilojmë planet e përkrahjes dhe së bashku i analizojmë ato, në mënyrë që të kontrollohen përparimet.

Nxitja shëruese pedagogjike bëhet në shtëpi, në ambientin e besueshëm, por mund të bëhet edhe në dhomat tona. Gjithmonë varësisht prej situatave, ne punojmë në kuadër të orëve të veçanta ose në grupe të vogla. Intensiteti i nxitjes shëruese pedagogjike i përshtatet vazhdimisht nevojave të fëmijës dhe të familjes së saj.

Qëllimi: Integrimi më i mirë i mundshëm

Qëllimi i edukimit të hershëm në pikëpamje të pedagogjisë shëruese është integrimi më i mirë i mundshëm i fëmijëve me spikatje që biejnë në sy në zhvillimin e tyre, në shtëpitë e tyre dhe në ambientin e tyre. Vlen që aftësitë e fëmijës të zgjerohen konform mundësive të saj si dhe në përputhje me porosinë që përmban nxitja.